UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT

PUNIMI I DIPLOMËS – MASTER

Tema

NDIKIMI I DEFORMITETEVE TË GJOKSIT NË ZHVILLIMIN MORFOLOGJIK DHE MOTORIK

MENTORI:
Prof. Asoc.Dr. Abdulla Elezi

KANDIDATI:
Sadik Shala

Prishtinë, mars, 2018

PËRMBAJTJA

1. HYRJE **3**
1.2. NDËRTIMI ANATOMIK I KAFAZIT TË KRAHARORIT 6
2. QËLLIMI I PUNIMIT **15**
3. HPOTEZAT THEMELORE **17**
4. METODAT E HULUMTIMIT **18**
4.1 PËRKUFIZIMI I MOSTRËS SË HULUMTIMIT 18
4.2 NDRYSHORET ANTROPOMETRIKE 19
4.3 NDRYSHORET MOTORIKE 19
4.4 DEFORMITETET E GJOKSIT 19
4.5 PËRSHKRIMI I DEFORMITETEVE TË GJOKSIT 19
4.6 TEKNIKAT E MATJES 22
4.6.1 Teknika e matjeve të ndryshoreve antropometrike 22
4.6.2 Teknika e matjeve të ndryshoreve motorike 30
4.5 METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE 37
5. INTERPRETIMI I REZULTATTEVE DHE DISKUSUTIMI **38**
5.1 ANALIZA DESKRIPTIVE E NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE TE NXËNËSIT PA DEFORMITETE 38
5.2 ANALIZA DESKRIPTIVE E NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE TE NXËNËSIT ME DEFORMITETE 43
5.3 KOEFICIENTËT E NDËRLIDHJEVE 48
5.3.1 Koeficientët e ndërlidhjeve ndërmjet ndryshoreve antropometrike dhe motorike 48
5.4 DALLIMI NË NDRYSHORET ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE 51
5.4 1 Dallimet në mes nxënësve pa deformitete dhe me deformitete të gjoksit në ndryshoret antropometrike dhe motorike 51
5.4 VËRTETIMI I HPOTEZAVE 52
6. PËRFUNDIMI **53**
7. LITERATURA **55**
REZYME **57**
SUMMARY **58**

1. HYRJE

Rritjen dhe zhvillimin duhet ta konsiderojm në përgjithësi si procese dinamike që zhvillohen vazhdimisht nga lindja deri në pjekurin e plotë. Edhe pse parimet e rritjes dhe zhvillimit përafërsisht të njëjta për çdo individ, rezultatet e shumta të monitorimit dhe kërkimeve shkencore dhe varijantat dhe devijimeve personale. Pikërisht për shkak, se ne në praktikë shpesh e kemi të vështira të nxjerrim kufirin në mes variacioneve normale dhe devijimeve patologjike, është e nevojshme ti njohim normat dhe standardet, në mënyrë që vlerësimi të jetë sa ma objektiv.

Organizmi i njeriut, sikurse çdo trup në hapësirë, i nënshtrohet ligjeve të fizikës. Veprimi i forcave mekanike tek njeriu më së shumti mund të evidentohet dhe regjistrohet në aparatin lokomotor.

Në trupin e njeriut pandërprerë vepron forca e gravitetit, me tendencë që ti qetë nga ekuilibri dhe të përkulë pjesë të trupit kah toka. Kësaj dukurie i kundërvihen forcat aktive dhe pasive të organizmit, gjatë së cilës angazhohen që pjesët e trupit dhe trungu të mbahen në kufijtë fiziologjik.

Forca e gravitetit, me tendencë që ti qetë nga ekuilibri dhe të përkulë pjesë të trupit kah toka më e shprehur është në fazat e zhvillimit të fëmijës kur sistemi lokomotor është në zhvillim e sipër dhe duke u forcuar dhe në periudhën e pleqërisë kur muskujt dobësohen.

Me shprehjen zhvillim i femijes ose me drejt rritje dhe zhvillim i femijes ne kuptojme ne pergjithesi shtesat dhe ndryshimet ne peshe e ne gjatesi qe nga lindja e femijes e deri ne perfundimin e rritjes se tij.

Megjithese pesha e gjatesia jane tregues kryesore per te vleresuar zhvillimin e femijes ne e kemi per detyre te mesojme prinderit se vetem ato nuk jane te mjaftueshme per te gjykuar mbi zhvillimin e foshnjes.

Deformitetet trupore paraqiten me ndryshime morfologjike të aparatit lokomotor të cilat përcillen me ndryshime të caktuara funksionale të sistemeve të organizmit . Deformitetet trupore atakojnë pothuajse te gjitha pjesët e organizmit dhe varësisht nga shkalla e paraqitjes së tij shkaktojnë pengesa ne organizëm. Në mesin e deformiteteve të

shumta që paraqiten tek njeriu potencojmë, deformitetet e kafazit të kraharorit ,ndër të cilat më të shpeshta janë : “ gjoksi i pulës”, “gjoksi i këpucëtarit” dhe “gjoksi i rrafshët”.

Rëndësia e njohjes së këtyre deformiteteve dhe nevoja e pakontestueshme për preventiven dhe shërimin e tyre mbështetet në raportet e kafazit të kraharorit dhe organeve në hapësirën e tij. Prandaj për ti njohur këto raporte shtrohet nevoja e analizës topografike të kafazit të kraharorit në mënyrë që më vonë të kemi një pasqyrë të qartë të pasojave te deformiteteve të lartshënuara.

Deformitete e kafazit të kraharorit ndikojnë direk në organet e brendshme, sidomos në funksionimin normal të zemrës dhe mushkërive. Këto dy organe janë përgjegjëse për furnizimin e organizmit me oksigjen gjatë aktiviteteve fizike.

Niveli i zhvillimit fizik dhe i aftësive psikomotorike është parakusht i domosdoshëm për çdo lloji të lëvizjes së njeriut e për këtë edhe për çdo aktivitet kineziologjik ose aktivitet sportiv. Ky zhvillim është i varur nga gjendja shëndetësore e njeriut ku bëjnë pjesë edhe deformitetet e kraharorit.

Kohë gjatësia, intensiteti dhe numri i përsëritjeve i strukturave të ndryshme lëvizore, përcaktojnë rëndësinë e disa aftësive fizike. Është e njohur thënia që sa më e ndërlikuar të jetë aktiviteti kineziologjik sipas strukturës së lëvizjes tek ajo paraqitet numër më i madh i aftësive të ndryshme motorike.

Parakusht i rëndësishëm për veprim të dobishëm të aktiviteteve trupore në organizëm është ajo se duhet të jetë drejt e programuar për çdo individ, sepse aktiviteti jo adekuat i tepruar mundë, në vend se të ketë dobi të sjellë deri tek pasojat e dëmshme për organizëm.

Në kushtet e mungesës së aktiviteteve trupore sistemet e organeve të organizmit kalojnë nëpër shumë ndryshime, të cilat në fund rezultojnë me zhvillimin e proceseve të ndryshme patologjike, veçanërisht në sistemin kardiovaskular. Paralelisht me dukurit e tilla lajmërohen edhe çrregullime në punën e organeve të tjera të rëndësishme siç janë mushkrit, mëlçia, veshkat e tjera. Gjithë e më tepër zvogëlimi i aktiviteteve trupore në jetën e përditshme kushtëzon rendësin gjithë e më të madhe të aktiviteteve sportive si një ndër faktorët preventiv.

Aktivitetet trupore dhe sportive të programuara drejt sjellin deri tek shumë ndryshime pozitive në organizmin e njeriut edhe atë duke e rritur pranimin e oksigjenit,

përmirësimin e funksionimit të sistemit kardiovaskular, procese metabolike më të mira, normalizimin e peshës trupore, ndryshime pozitive në sistemin nervor qendror, rritjen e aftësive psikomotorike, funksion më të mire të organeve të frymëmarrjes e tjera. Rezultat i këtyre ndryshimeve pozitive morfologjike, funksionale dhe motorike në organizëm në përgjithësi rezulton me përtëritje biologjike dhe ngritjes së shkallës shëndetësore çka individin e kthen në një rend të njëjtë me të rinj e aftë për punë.

Me fjalë të tjera, lëvizja në përgjithësi, veçanërisht, ushtrimet sistematike, trainingu sportive, dhe aktivitetet gjatë lojës, të harmonizuara me moshën e individit, janë faktor të rëndësishëm të zhvillimit trupor, funksional dhe motorik. Në esencë, nga pikëpamja antropologjike, faktorët endogjen dhe ekzogjen me anë të bashkëveprimit rregullojnë karakteristikat e njeriut, sjelljet dhe zhvillimin e tij.

Faktorët që kanë ndikim pozitiv dhe negativ në zhvillimin e gjithëmbarshëm të njeriut janë të shumtë. Mirëpo në këtë punim do ta hulumtojmë vetëm ndikimin e deformiteteve të kafazit të kraharorit si faktor i brendshëm i cili ka ndikim të caktuar në disa nga nënsistemet e organizmit tonë e sidomos në atë respirator dhe kardiovaskular me këtë edhe në organizëm në përgjithësi, konkretisht në zhvillimin morfologjik dhe motorik.

1.2. NDËRTIMI ANATOMIK I KAFAZIT TË KRAHARORIT

Funksioni i eshtrave në organizmin e njeriut mund të vështrohet nga tri aspekte themelore si :

1. Formojnë skeletin dhe trupin e njeriut ne tërësi
2. Realizojnë funksionin e levës kur është fjala për eshtra të gjatë dhe
3. Mbrojnë organet e caktuara të brendshme të organizmit (trupin, mushkëritë, zemrën etj).

Rëndësia e mbrojtjes së këtyre organeve pasqyrohet nga fakti se ato paraqesin elementin esencial të jetës së njeriut, e sidomos organet e sistemit kardiovaskular dhe të atij respirator që gjenden në hapësirën e kafazit të kraharorit.

Kafazi i kraharorit (thorax) është një hapësirë e formuar nga vertebra e kraharorit, nga brinjët dhe sternumi. Kafazi i kraharorit në pjesën e tij të sipërme ka formë konike, kurse në pjesën e poshtme ka formën cilindrike . Ai mban dhe mbron organet kryesore – qendrore të frymëmarrjes dhe qarkullimit të gjakut (mushkëritë dhe zemrën).

Koshi i kraharorit për lehtësi studimi ndahet në pjesët që vijojnë:

1. Faqja e jashtme
2. Faqja e brendshme
3. Hapja e sipërme e kraharorit dhe
4. Hapja e poshtme e kraharorit

Faqja e jashtme

Shikuar nga jashtë kafazi i kraharorit vërehet se është i formuar nga katër pjesë : një e përparme një e prapme dhe dy anësore.

a) Pjesa e përparme është e sheshtë më e gjerë poshtë se sa sipër. Është e formuar nga sternumi nga artikulacionet kondro-sternale, nga kërcet brinjore,nga skajet e përparme (sternale) të brinjëve dhe nga hapësirat ndër brinjore.

b) Pjesa e prapme kufizohet nga dy vija të pjerrëta që kalojnë nëpër këndet brinjore. Është e formuar nga kreshta vertebrale, nga dy ulluqet vertebrale, nga faqet e jashtme të brinjëve dhe nga hapësira ndër brinjore.
c) Pjesët anësore përfshijnë hapësirat që shtrihen ndërmjet dy pjesëve të sipërme dhe janë të formuara nga brinjët dhe hapësirat ndër brinjore. Çdo hapësirë ndër brinjore (spatium intercostale) ka një gjatësi dhe gjerësi të ndryshme. Janë gjithsej njëmbëdhjetë për çdo anë dhe mbushen nga muskujt ndër brinjorë.

Faqja e brendshme

Po të shikohet kafazi i kraharorit nga brenda, vërehet se ndryshon nga trajta e jashtme. Faqja e brendshme nuk është konkave në të gjitha pikat, nga prapa ka një të dalur, të shkurtuar nga trupat e vertebrave të kraharorit. Kjo e ndanë hapësirën e kraharorit në dy pjesë që mbushen nga mushkëritë përkatëse. Faqja e brendshme, si ajo e jashtme formohet nga katër pjesë: e përparmja, e prapmja dhe dy anësoret.

Hapja e sipërme e kraharorit

Nga përpara kufizohet me “incisura jugullaris” e dërrasës së kraharorit, anash nga buzët mediale të brinjëve të para dhe prapa nga trupi i vertebrës së parë të kraharorit. Ka formë eliptike me diametër më të madh,atë tërthor dhe mban drejtim të pjerrët nga lart poshtë dhe nga brenda jashtë. Nëpër këtë kalojnë organe që zbresin nga qafa në kraharor dhe anasjelltas.

Hapja e poshtme e kraharorit

Është më e gjerë se e sipërmja dhe kufizohet nga e para me trupin e vertebrës së dymbëdhjetë të kraharorit, nga e para me zgjatimin ksifoid dhe anash nga harqet brinjore të brinjëve të njëmbëdhjeta dhe të dymbëdhjeta. Kjo ndanë hapësirën e kraharorit nga ajo e barkut dhe zihet në skelet me një muskul membranor që quhet “diafragma”. Harqet brinjore kufizojnë në vijën e mesit një kënd, i cili ndryshon sipas moshës dhe individëve . Ky kënd është më i gjerë tek fetusi, fëmija dhe gruaja se sa tek burri.

Aspekti funksional i kafazit të kraharorit

Koshi i kraharorit gjatë zhvillimit paraqet ndryshime të rëndësishme tek fetusi, fëmiu, si dhe tek i rrituri. Tek fetusi kraharori është i zhvilluar më tepër në drejtim nga para prapa se sa nga ana tërthore. Kjo ndodhë për shkak të zhvillimit të mangët të mushkërive dhe zhvillimit te konsiderueshëm të zemrës, ndërsa baza e kraharorit është mjaft e gjerë për shkak të zhvillimit të madh të organeve të barkut, sidomos të mëlçisë së zezë. Pas lindjes, kur fëmija fillon të kryej frymëmarrje të pavarur, kraharori zmadhohet nga të gjitha anët, por më tepër në mënyrë tërthore. Kështu kraharori gradualisht merr formën definitive në moshën 18 vjeçare. Forma e kraharorit ndryshon edhe sipas gjinisë. Te mashkulli është më i gjerë në bazë, te femra është më i shkurtër dhe më i rrumbullakët dhe ngushtimi i bazës është më i theksuar.





Fig. 1. Kafazi i kraharorit

Kështu kraharori gradualisht merr formën definitive në moshën 18 vjeçare. Forma e kraharorit ndryshon edhe sipas gjinisë. Tek mashkulli është më i gjerë në bazë, te femra është më i shkurtër dhe më i rrumbullakët dhe ngushtimi i bazës është më i theksuar.

Brinjët (costae)

Brinjët janë harqe elastike eshtërore që formojnë muret e kraharorit. Gjithësejt janë dymbëdhjetë palë. Brinjët nga prapa lidhen me vertebrat përkatëse, kurse përpara me anë të kërceve brinjore lidhen me dërrasën e kraharorit, mirëpo mënyra e lidhjes nuk është e njëjtë për të gjitha brinjët. Shtatë brinjët e para bashkohen me dërrasën e kraharorit me anë të kërceve të tyre dhe quhen brinjë të vërteta (costae verae), ndërsa pesë të fundit

quhen brinjë të rreme (costae spuriae), prej të cilave tri të parat bashkohen me kërce ndërmjet tyre duke formuar kështu harkun ndërbrinjor. Dy brinjët e fundit janë të lira në anën e përparme dhe quhen (costae fluctuantes). Brinjët janë mjaft të gjata, por gjatësia e tyre nuk është e njëjtë. Këto zmadhohen gradualisht nga brinja e parë deri tek e teta, e prej këtej zvogëlohen deri tek e dymbëdhjeta. Karakteristikë e përbashkët e brinjëve është se janë eshtra të gjatë, të sheshtë dhe në secilën bri dallojmë : trupin dhe dy skajet. Skaji vertebral i çdo brinje ka kokën (caput costae), dhe faqet artikulare që lidhen me dy vertebra. Pas kokës vjen pjesa e hollë qafa (collum costae) poshtë së cilës gjendet një gungë (tuberculum costae).Afër gungës gjendet një faqe artikulare,ku bëhet artikulimi me gropën e zgjatimeve tranzverzale të vertebrave. Pak nga larg gungës gjendet këndi i brinjës (angulus costae). Skaji sternal përfundon me një faqe eliptike, pak a shumë konkave, që bashkohet me kërcin brinjor përkatës. Trupi i brinjëve (corpus costae) është i gjatë dhe i sheshtë. Ka dy faqe dhe dy buzë. Faqja e përparme është konvekse dhe e lëmuar, faqja e brendshme është konkave dhe gjithashtu e lëmuar. Afër buzës së poshtme ka një brazdë (sulcus costae). Në këtë brazdë kalojnë enët e gjakut dhe nervat ndërbrinjorë , buza e sipërme është e rrumbullakët, ndërsa e poshtmja është mjaft e mprehtë.



Fig. 2. Pjesët e kafazit të kraharorit

Dërrasa e kraharorit (sternum)

Dërrasa e kraharorit është një kockë teke e vendosur në mes në anën e përparme të kraharorit, ndërmjet dy klavikulave dhe shtatë palë brinjëve të para që kapen me të . Ka drejtim të pjerrët. Në të dallojmë tri pjesë duke filluar nga lartë poshtë : dorëza, trupi dhe maja. Dorëza (manubrium sterni) është më e gjerë dhe më e trashë. Buza e sipërme e saj është e trashë, paraqet në mes një të thelluar (incisura jugullaris), dhe anash ka

gjithashtu dy të thelluara (incisura clavicularis); në këto vende artikulohet dërrasa e kraharorit me klavikulen. Buza e poshtme bashkohet me trupin e këti ashti, dhe formon një kënd të dalur para (angulus sterni). Në buzët anësore gjendet nga një e thelluar për tu artikuluar me brinjën e parë. Trupi (corpus sterni) është më i gjatë dhe më i hollë se dorëza. Faqja e përparme është pak konvekse dhe e ashpër, ndërsa e përparmja është konkave dhe më e lëmuar. Në buzët anësore të trupit gjenden katër të thelluara ku artikulohen brinjët (incisurae kostales). Maja (processus xyphoideus) është më e vogël nga dy të parat. Është e hollë dhe nuk është gjithnjë njëlloj për sa i përket gjatësisë, drejtimit dhe formës së saj. Kështu ajo mund të jetë e rrumbullakët, e mprehtë, e ndarë në dysh, mund të përshkohet nga një vrimë etj. Dërrasa e kraharorit tek femrat është më e ngushtë dhe më e gjatë se tek meshkujt, më pak e pjerrët dhe i ofrohet mjaft vertikales. Afër buzës së poshtme ka një brazdë (sulcus costae). Në këtë brazdë kalojnë enët e gjakut dhe nervat ndërbrinjorë , buza e sipërme është e rrumbullakët, ndërsa e poshtmja është mjaft e mprehtë.



Fig. 3. Ndërtimi anatomik i sternumit

Ndërtimi muskulor

Muskujt e kraharorit ndahen në dy grupe. Njëri grup përfshinë muskujt që lidhin koshin e kraharorit me skeletin e brezit të shpatullës dhe humerusin. Grupi tjetër përfshinë muskujt që i përkasin vet koshit të krahut. Në grupin e parë gjenden: muskuli i madh i kraharorit, muskuli i vogël i kraharorit dhe muskuli dhëmbëzor i përparshëm. Në grupin e dytë hyjnë : muskujt ndërmjet brinjëve dhe te ndërbrinjëve, muskuli tërthor i kraharorit dhe diafragma.



Fig. 4. Muskujt e kafazit të kraharorit

Afër buzës së poshtme ka një brazdë (sulcus costae). Në këtë brazdë kalojnë enët e gjakut dhe nervat ndërbrinjorë , buza e sipërme është e rrumbullakët, ndërsa e poshtmja është mjaft e mprehtë.

Muskuli i madh i kraharorit (musculus pectorais major)

Është një ndër muskujt më të zhvilluar të gjoksit. Ndodhet në pjesën e përparme dhe të sipërme të kraharori, është i trashë dhe ka formë trekëndëshi. Ai mbulon pjesën më të madhe të faqes së përparme të kraharorit. Ky muskul është i formuar nga tri pjesë : pjesa klavikulare, sternokostale dhe pjesa e barkut.



Fig. 5. Muskujt i madh i kafazit të kraharorit

Muskuli i vogël i kraharorit (musculus pectorais minor)

Gjendet nën muskulin e madh të kraharorit dhe mbulohet i tëri nga ai. Është muskul i sheshtë, në formë trekëndëshi dhe shtrihet nga brinjët tek zgjatimi kërkoid i shpatullës.



Fig. 6. Muskujt i i vogël i kafazit të kraharorit

Muskuli dhëmbëzor i përparshëm (musculus serratus anterior)

Është i gjerë dhe i sheshtë qe mbulon muret anësore të kraharorit, dhe gjendet në pjesën më të madhe të tij. Fillon nga faqja e jashtme e nëntë brinjëve të para me anë dhëmbëzimesh krejtësisht të dalluara, të cilat kapen në shpatull.



Fig. 7. Muskujt i dhëmbëzor i kafazit të kraharorit

Muskujt ndërmjet brinjëve (musculi intercostales)

Mbyllin hapësirat ndërmjet brinjëve. Këta muskuj i ndajmë në muskuj të jashtëm ndërmjet brinjëve dhe muskuj të brendshëm ndërmjet brinjëve. Muskujt e jashtëm ndërmjet brinjëve (musculi intercostales externi) kapen sipër në buzën e poshtme të një brinje dhe poshtë në buzën e sipërme të brinjës së poshtme. Edhe muskujt e brendshëm

ndërmjet brinjëve (musculus intercostales interni) mbushin hapësirat ndër brinjore përkatëse*.



Fig. 8. Muskujt ndërmjet brinjëve të kafazit të kraharorit

Diafragma

Diafragma është një muskul i gjerë, i hollë, në formë kubeje me konkavitet nga poshtë. Ajo kapet me bazën e kafazit të kraharorit formon murin e poshtëm të zgavrës së kraharorit, dhe e ndanë këtë nga zgavra e barkut. Qendra e këti muskuli është e ndërtuar nga aponeurozë, ka formën e një trifili dhe quhet qendra tendinoze (centrum tendineum). Në pjesën muskulore dallojmë : pjesën e belit , pjesën brinjore dhe pjesën sternale*



Fig. 9. Muskujt ndërmjet brinjëve të kafazit të kraharorit

---

* **Anatomia normale e njëriut " muskujt e krahërorit . fq . 125 – 126**

***Dr. Petro Papadhopuli , Anatomia normae e njëriut , Verona , Prishtinë. 1972. fq 127**

2. QËLLIMI I PUNIMIT

Është shumë e rëndësishme të dijmë që me ushtrime dhe aktivitete fizike të fillohet që në moshë të vogël, pasi kjo ndikon pozitivisht në shëndetin e njeriut. Aktiviteti fizik ndihmon në formimin e muskujve dhe kockave, rritjen e sistemit imunitar, ndihmon në sëmundjet e gjakut dhe zemrës, si dhe në shëndetin mendor. Deformitetet trupore ne përgjithësi në kuadër të kësaj dhe deformitetet e kafazit të kraharorit në veçanti kanë ndikim në zhvillimin morfologjik dhe motorik të njeriut. Duke u nisur nga ky fakt parashtrohet edhe qëllimi i këtij hulumtimi.

Qëllimi primar i këtij punimi është që të pasqyrohet ndikimi i deformiteteve të gjoksit në disa parametra antropometrik dhe motorike.

Qëllimi sekundar i këtij punimi është që të pasqyrohet si dhe të vërtetohet dallimi në mes nxënësve me deformitete dhe pa deformitete të gjoksit në zhvillimin morfologjik dhe motorik.

3. HPOTEZAT THEMELORE

Duke u mbështetur në qëllimin e këtij punimi janë parashtruar këto hipoteza :

Hipoteza 1. Pritet se ndryshoret antrpometrike dhe motorike te nxënësit e moshës 17-18 vjeçare me deformitete dhe pa deformitete të gjoksit do të kenë asimetri më të theksuar.

Hipoteza 2. Pritet të fitohen korelacione të rëndësishme në mes ndryshoreve antropometrike dhe motorike te nxënësit e moshës 17-18 vjeçare me deformitete dhe pa deformitete të gjoksit.

Hipoteza 3. Pritet një dallim i rëndësishëm statisatikor në ndryshoret antropometrike dhe motorike në mes nxënësve të moshës 17-18 vjeçare me deformitete dhe pa deformitete të gjoksit.

4. METODAT E HULUMTIMIT

4.1 PËRKUFIZIMI I MOSTRËS SË HULUMTIMIT

Për realizimin e qëllimit të këtij punimi mostra është zgjedhur nga popullata e nxënësve të shkollave të mesme të komunës së Lipjanit, Gjimnazi "Ulpiana" dhe Sahkolla Profesionale "Adem Gllavica".

Mostra për këtë hulumtimit ka përfshir gjithsej 40 nxënës të moshës 17-18 vjeçare, do të thot, 20 nxënës pa deformitete të gjoksit dhe 20 nxënës me deformitete të gjoksit . Të testuarit në këtë hulumtim vullnetarisht kanë shpreh dëshirën për pjesëmarrjen e tyre në hulumtim dhe kanë marr miratimin e prindërve të tyre.

4.2 NDRYSHORET ANTROPOMETRIKE

Në këtë hulumtim janë përfshir 8 ndryshore antropometrike

1. Lartësia e trupit …….….…ALART
2. Gjatësia e këmbës …….…..…AGJKË
3. Pesha e trupit …….……...APESH
4. Perimetri i gjoksit …….……APGJO
5. Diametri i bërrylit…….……ADBRY
6. Diametri i gjurit …….……... ADGJU
7. Indi dhjamor nën lëkuror i krahut …….AIDHK
8. Indi dhjamor nën lëkuror i barkut …….AIDHB

4.3 NDRYSHORET MOTORIKE

Në këtë hulumtim janë përfshir 7 ndryshore motorike

1. Vrapim 20m starti i lartë……...….**MV20L**
2. Vrapim 100m starti i lartë…….….**MV100L**
3. Vrapim 400m starti i lartë…….….**MV400L**
4. Vrapim 800m starti i lartë…….….**MV800L**
5. Kërcim nga vendi gjatësi …….……..**MKVGJ**
6. Taping me dorë…….....**MTDOR**
7. Fleksibiliteti përkulje para…….**MFPPA**

4.4 DEFORMITETET E GJOKSIT

Për qëllimet e këtij hulumtimi janë përfshirë nxënësit me këto deformitete të gjoksit:

Gjoksi i pulës (pectus curinatum)

Gjoksi i këpuctarit (pectus excavatum)

Gjoksi i rrafshët (pectus planum)

4.5 PËRSHKRIMI I DEFORMITETEVE TË GJOKSIT

1. Gjoksi i pulës (pectus curinatum)

Ky deformitet i pjesës së përparme te kafazit të kraharorit që është më së shpeshti pasojë e çrregullimit të metabolizmit mineral të kalciumit (rakitis), ende është i pranishëm te fëmijët edhe përkundër përpjekjeve sistematike profilaktike në mbrojtjen shëndetësore. Nganjëherë gjendet edhe tek fëmijët të cilët janë të sëmurë nga astma respiratore kronike. Në pamje klinike krahas gufimit përpara të ashtit të kraharorit (os sternum) dhe pjesës së përparme të brinjëve në pjesën hapësinore të koshit të kraharorit, konstatojmë brinjë të future pakëz brenda (vija e malipijevit) duke ngritur harkun e formuar të brinjëve (arcus kostarum). Në të njëjtën kohë mund te gjenden shenja të deformitetit rakitik të skeletit edhe në pjesët tjera të trupit p.sh. “ O ” dhe “ X ” te këmbët etj. Deformitetet e përqendruara janë mjaft të dukshme te fëmijët e gjinisë mashkullore, kurse tek gjinia femërore janë të fshehura në yndyrë të butë. Te ky deformitet nuk është i rrezikuar funksioni i sistemit respirator dhe kardiovaskuar me përjashtim të rasteve të rënda me kompresion të theksuar të pjesës së përparme të kafazit të kraharorit . te këta fëmijë të shpeshta janë sëmundjet e traktit të frymëmarrjes në bazë të reduktimit eventual të ventilimit të mushkërive për arsye se lëvizshmëria respiratorë e kafazit të kraharorit është e reduktuar për shkak të drejtimit (shtrirjes) jot e rregullt të brinjëve Ky deformitet mund të shërohet në mënyrë operative në femërinë e hershme (4-5 vite)ose të tentohet në mënyrë konzervative me shtrënguesin ortopedik.



Foto. 1. Deformiteti i kafazit të kraharorit-gjoksi i pulës (pectus curinatum)

2 Gjoksi i këpucarit (pectus excavatum)

Ky deformitet quhet “gjoksi i këpucarit” sepse konsiderohet se mund të paraqitet si pasojë e profesionit (këpucarit). Koshi i kraharorit është i gropëzuar në drejtim të kundërt nga deformiteti i lartpërmendur (gjoksi i pulës), këtu është i shprehur zvogëlimi i diametrit të koshit të kraharorit në rrafshin sagjital, kështu që i tërë koshi i kraharorit është i ndryshuar, i gjerë , i ngjeshur dhe i shkurtër

Gjoksi i këpucëtarit është defrmitet i cili shfaqet si pasojë e ndërrimit të formës së stërnumit i cili është i thelluar më së shpeshti në pjesën kaudae me pjesët përkatëse të brinjëve. Etioogjia eshte rralle rakitike e më shpesh kongjenitale. Në përqindje të vogël mund të jetë edhe i trashëguar. Ky deformitet mund të gjendet edhe tek fëmijët të cilët vuajnë nga sëmundja e astmës. Në kuptimin funksional vie deri te vështërsimi i punës së organeve respiratore, kurse konpresioni i drejtpërdrejtë mund të shkaktojë ndryshime në enët e mëdha të gjakut të koshit të kraharorit dhe zemrës. Në rastet kur deformiteti është tëjet i theksuar për shkak të ndalesës së qarkullimit fëmija është i zbehtë, apo pak a shumë cianotik. Kapaciteti i vita i mushkërive është i zvogëluar. Arsimtari i kulturës fizike duhet ti ketë parasysh me rastin e planifikimit dhe realizimit të orës mësimore dhe aktiviteteve tjera kineziologjike, për arsye se këta fëmijë janë të pa aftë për vrapime, e sidomos për sportet të cilat kërkojnë kapacitet më të madh respirator. Te ky deformitet është i nevojshëm intervenimi operativ i cili mund të bëhet qysh në fëmijërinë e hershme (4-5 vite).



Foto. 2. Deformiteti i kafazit të kraharorit-gjoksi i këpuctarit (pectus excavtum)

3 Gjoksi i rrafshët (pectus planum)

Ky defrmitet, sipas autorëve, nuk duhet numërua çdoherë në gjendjet të cilat në masë të madhe devijojnë nga normalja, por është faktike se ekzistojnë çrregullime në zhvillimin e muskulaturës së koshit të kraharorit. Ky deformitet është tërësisht i llojit tjetër nga dy deformitetet e lartshënuara, për arsye se këtu kemi të bëjmë me ndryshime në indet muskulore të kafazit të kraharorit. Mirëpo krahas muskulaturës së dobësuar mund të konstatohen anomali tjera në vet kafazin e kraharorit, të cilat kryesisht paraqiten në mungesë të fryrjes fiziologjike te kafazit të kraharorit. Personi i tillë duket i ngushtë, i hollë, nuk dallohet relievi i zakonshëm i muskulaturës për arsye se ajo zakonisht është hipertrfikë. Shkaku i paraqitjes së këti deformiteti zakonisht e ka zanafillën me paraqitjen (lajmërimin)e shenjave të rakitit ashtu që fëmijët janë dobët të zhvilluar.

Foto. 3. Deformiteti i kafazit të kraharorit -gjoksi i rrafshët (pectus planum)

4.6 TEKNIKAT E MATJES

4.6.1 Teknika e matjeve të ndryshoreve antropometrike

Ndryshoret antropometrike[*] janë matur sipas mënyrës siç vijon:

1. Lartësia e trupit (ALART) është matë me antropometër sipas Martinit. Gjatë matjes i testuari është i zbathur në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim në bazën e rrafshët të antropometrit. Koka e të testuarit duhet të jetë në aso pozite që drejtëza e Frankfurtit të jetë horizontale. I testuari drejton shpinën aq sa është e mundur, dhe shputat i ka të bashkuara. Testuesi qëndron nga ana e majtë dhe kontrollon se akrepi i antropometrit a është vendosur vertikalisht në mënyrë të drejtë drejtpërdrejt përgjatë pjesës së mbrapse të trupit të testuarit dhe pastaj, lëshon unazën metalike (rrëshqitësin) ashtu që akrepi horizontal të vendoset në mënyrë të drejtë në majën e kokës. Atëherë lexohet rezultati në shkallën e matjes të antropometrit me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 4. Lartësia e trupit (ALARTE)

[*] Të gjitha matjet janë ekzekutuar sipas metodës të cilën e ka propozuar IPB (International Biologic Program) Programi biologjik ndërkombëtar. PBN (Programi biologjik ndërkombëtar) ka përgatitur listën e matjeve antropometrike duke e pasur parasysh nevojën e atyre që merren me hulumtime të karakteristikave të trupit të njeriut në kushte të ndryshme e që shpesh nuk janë antropolog. Nga lista e matjeve antropologjike të propozuara nga Programi biologjik ndërkombëtar, gjithsejtë 39 matje, për nevojat e këtij hulumtimi janë përdorur 12 matje antropometrike (nga tri matje të çdo dimensioni morfologjik. Parametrat e treguesve antropometrik maten sipas procedures të cilat i kanë (në bazë të propozimit të autorit Stoudt dhe Mc Farlanta) përpunue M.Stojanoviç i Z.Stojkovië.

2. Gjatësia e këmbës (AGJKË) – i eksperimetuari duhet të qendroj sikurse në matjen e lartesis së trupit, matje është kryer me sherit centimetrik nga dyshemeja ku qendron entiteti deri te pika e quajtur "gjembi i siperm i perparm i çopokut" në anën e majtë të këmbës. Rezultati lexohet me saktesi 0.1 cm.

Foto 5. Gjatësia e këmbës (AGJKË)

3. Pesha e trupit (APESH) është matë me peshore transportabile të vendosur në sipërfaqe të rrafshët. I testuari, zbathur dhe në brekë vendoset në mesin e peshores dhe qëndron në drejtqëndrim. Atëherë kur akrepi në peshore nuk lëvizë, rezultati lexohet me saktësi prej 0,5 kg.

Foto 6. Pesha e trupit (APESH)

4. Perimetri i gjoksit (**APGJO)** është matë me traken matëse plastike. Para matjes i testuari është i zbathur, në brekë dhe qëndron në drejtqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Traka matëse mbështjellët rreth gjoksit në një pozitë horizontale ndaj boshtit të trupit, duke kaluar horizontalisht nëpër pikat e lidhjes së brinjëve 3. dhe 4. për kockën e gjoksit. Rezultat i matjes lexohet atëherë kur kafazi i kraharorit është në pozitë mesatare (në fund të ekspiriumit normal, respektivisht, në pauzë ndërmjet inspirimit dhe ekspirimit). Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 7. Perimetri i gjoksit (**APRGJ)**

5. Diametri i bërrylit (ADBRY) –(diametri bikondilar i krahut) është matë me nanous. Gjatë matjes i testuari është në brekë dhe i zbathur dhe qëndron në drejtqëndrim me krah të lakuar në kënd të drejt. Majet e akrepave të nanousit vendosen në pjesën e brendshme dhe të jashtme të epykondilusave të krahut me presion të mjaftueshëm që të largohet indi i butë. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 8. Diametri i bërrylit (ADBRY)



6. Diametri i gjurit (ADGJU) – (diametri bikondilar i kofshës) është matë me nanous. Gjatë matjes i testuari është i zbathur dhe në brekë, qëndron i ulur. Këmba e majtë është e lakuar në këndë të drejtë në gju. Majet e akrepit të nanousit vendosën në pjesën e brendshme dhe të jashtme të epikondilusit të femurit me një presion të mjaftueshëm që indi i butë të largohet. Rezultati lexohet me saktësi prej 0,1 cm.

Foto 9. Diametri i gjurit (ADGJU)



7. Indi dhjamor nën lëkuror i krahut (**AIDHK)** është matë me kaliper "John Bull" i rregulluar ashtu që shtypja e skajeve të krahëve të kaliperit në lëkur të jetë 10gr/mm². Para matjes i testuari është i zbathur, në brekë qëndron në drejtqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues të dorës së majtë vërtikalisht kap lëkurën drejtpërdrejt në pjesën e mbrapme të krahut të majtë (tek muskuli triceps) në vendin e cila i përgjigjet mesit ndërmjet akromionit dhe olekranonit, duke patur kujdes që most ë kapet indi muskulor, kap palën (rrudhën) e lëkurës me majet e akrepave të kaliperit (të vendosur më poshtë se majet e gishtrinjëve. Rezultatet lexohen me saktësi prej 0,2 mm.

Foto 10. Indi dhjamor nën lëkuror i krahut (AIDHK)



8. Indi dhjamor nën lëkuror i barkut (AIDHB) është matë me kaliper. Para matjes i testuari është i zbathur, në brek dhe qëndron në drejtëqëndrim me duar të lëshuara nga poshtë dhe relaksim të muskujve të barkut. Testuesi me gishtin e madh dhe gishtin tregues të dorës së majtë horizontalisht kap lëkurën në anën e majtë të barkut në nivel të kërthizës (ombilikusit) dhe 5 cm në të majtë nga ai, duke patur kujdes që të mos kap edhe inde muskulore , kap palën (rrudhën) me majet e akrepave të kaliperit(të vendosur medialisht nga majet e gishtrinjëve). Rezultati lexohet me saktësi prej 0,2 mm

Foto 11. Indi dhjamor nën lëkuror i barkut (AIDHB)

4.6.2 Teknika e matjeve të ndryshoreve motorike

1. Vrapim 20 metra nga starti i lartë – MV20L

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgatitet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë:

Realizimi i detyrës: I testuari pas sinjalit për nisje duhet të vrapoj me shpejtësi maksimale deri në vijën e cakut, matet koha nga momenti i nisjes e deri në momentin kur i testuari me krahëror kalon rrafshin vertikal mbi vijën e cakut.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e cakut. Koha matet në saktësi 1/10 sec.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. Të testuarit udhëzohen që pas arritjes në vijën e cakut të vazhdojnë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.

Foto 12. Vrapim 20 metra nga starti i lartë – MV20L

2. Vrapim 100 metra nga starti i lartë – MV100L

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgatitet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë:

Realizimi i detyrës: I testuari pas sinjalit për nisje duhet të vrapoj me shpejtësi maksimale deri në vijën e cakut, matet koha nga momenti i nisjes e deri në momentin kur i testuari me krahëror kalon rrafshin vertikal mbi vijën e cakut.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e cakut. Koha matet në saktësi 1/10 sec.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. Të testuarit udhëzohen që pas arritjes në vijën e cakut të vazhdojnë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.

Foto 12. Vrapim 100 metra nga starti i lartë – MV100L

3. Vrapim 400 metra nga starti i lartë – MV400L

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgatitet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë:

Realizimi i detyrës: I testuari pas sinjalit për nisje duhet të vrapoj me shpejtësi maksimale deri në vijën e cakut, matet koha nga momenti i nisjes e deri në momentin kur i testuari me krahëror kalon rrafshin vertikal mbi vijën e cakut.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e cakut. Koha matet në saktësi 1/10 sec.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. Të testuarit udhëzohen që pas arritjes në vijën e cakut të vazhdojnë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.

Foto 12. Vrapim 400 metra nga starti i lartë – MV400L

4. Vrapim 800 metra nga starti i lartë – MV800L

Instrumentet: Kronometri me 1/10 sek.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari përgatitet për vrapim pranë vijës së startit, në pozitë të startit të lartë:

Realizimi i detyrës: I testuari pas sinjalit për nisje duhet të vrapoj me shpejtësi maksimale deri në vijën e cakut, matet koha nga momenti i nisjes e deri në momentin kur i testuari me krahëror kalon rrafshin vertikal mbi vijën e cakut.

Vlerësimi: Matet koha nga dhënia e sinjalit nga matësi ndihmës, deri në momentin kur i testuari kalon me trung vijën e paramenduar me vijën e cakut. Koha matet në saktësi 1/10 sec.

Udhëzime të testuarit: Në rast të startit jo të rregullt, vrapimi përsëritet. Të testuarit udhëzohen që pas arritjes në vijën e cakut të vazhdojnë vrapimin edhe për disa metra, duke u ndalur në mënyrë graduale.

Foto 12. Vrapim 800 metra nga starti i lartë – MV800L

5. Kërcim nga vendi në gjatësi – MKVGJ

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për kërcim.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari qëndron i kthyer me fytyrë kah drejtimi i kërcimit në pozitë drejtëqëndrimi me këmbë të thyera në gjujë që mundëson kërcim më të sukseshëm.

Realizimi i detyrës: I testuari kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Foto 13. Kërcim nga vendi në gjatësi – MKVGJ

6. Tapingu me dorë – MTDOR

Instrumentet: banka, karriga, dy pllaka nga letra e trashë me diametër 20cm, në largësi 61 cm nga njëri-tjetri (skajet e brendshme), shirit ngjitës të dukshëm dhe kronometri.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: I testuari ka qëndruar i kthyer me fytyrë kah matësi i kohës, ku ka qëndruar i ulur në karrige me duar të vendosura mbi bankë (njëra dorë në mes kurse tjetra në – në pllakën e djathtë). Pas disa tentimeve provuese, i testuari i ka zgjedhë largësinë e duhur nga banka.

Realizimi i detyrës: I testuari qëndron i ulur në karrige dhe vendos dorën më të dobët në bankë në mes të dy rrathëve, ndërsa dorën tjetër e vendos mbi pllakë. Detyra është që sa më shpejt ta takoj njërën, pastaj pllakën tjetër, në kohë prej 15 sekondash nga momenti i dhënies së komandës "tash".

Vlerësimi: shënohen të gjitha prekjet e rregullta të cilat matësi i numëron brenda 15 sek. Llogaritet çdo takim i dy pllakave (një cikël).

Udhëzime të testuarit: Të testuarve udhëzimet iu jepen gjatë demonstrimit të detyrës.

Foto 14. Tapingu me dorë – MTDOR

7. Fleksibiliteti, përkulje para – MFPPA

Instrumentet: Banak, metri milimetrikë i plastikes e përforcuar për dërrase të gjatë 80 cm dhe të gjerë 10 cm.

- Përshkrimi i detyrës:

- Pozita fillestare: I testuari qëndron mbi ulsën suedeze, me këmbë të drejta, në përkulje të thellë të trupit dhe me fytyrë nga drejtimi i përkuljes.

- Realizimi i detyrës: I testuari në përkulje të thellë dhe këmbë të drejta, në maje te gishtërinjve të dy shuplakave të cilat janë paralelisht njëra me tjetrën, të prekin sa më thellë metrin. Detyra përsëritet dy herë. I testuari e mban pozitën e fundit që leximi te jetë sa më i saktë.

- Vlerësimi: Shënohet rezultati i përkuljes më të thellë i shënuar me centimetra. Pika zero është në maje të centimetrave, saktësia e matjes 0,5 cm.

- Udhëzime të testuarit: Të testuarit iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. U tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta.

Foto 15. Fleksibiliteti, përkulje para – MFPPA

4.5 METODAT E PËRPUNIMIT TË REZULTATEVE

Duke marrë parasysh qëllimin e këtij hulumtimi do të zgjidhen procedurat për të cilat konsiderohet se korrespondojnë me natyrën e problemeve që hulumtohet.
Për çdo ndryshore antropometrike dhe motorike të do të llogariten vlerat e mëposhtme:

1. Parametrat qendrore themelor dhe të shpërndarjes:
   - Mesatarja aritmetikore (Ma)
   - Devijimi standard (Ds)
   - Vlera minimale (Min)
   - Vlera maksimale (Max)

2. Lakorja e shpërndarjes ose e shpërndarjes është testuar me anë të koeficientit të asimetrisë „skjunis”, dhe shkalla e lakimit e majës së kurbës "'kurtozis".

3. Raportet e ndërlidhjeve ndërmjet ndryshoreve antropometrike dhe testeve motorike në hapësirën manifeste, do të bëhet me anë të korelacionit sipas Pearsonit.

4. Për përcaktimin e dallimit në mes të nxënësve të moshës 17-18 vjeçare me deformitete dhe pa deformitete të të gjoksit në ndryshoret antropometrike dhe motorike do të aplikohet analiza e t-testit për grupe të pavarura.

5. INTERPRETIMI I REZULTATTEVE DHE DISKUSUTIMI

5.1 ANALIZA DESKRIPTIVE E NDRYSHOREVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE TE NXËNËSIT PA DEFORMITETE

Në tabelën 1 është paraqitur analiza deskriptive e ndryshoreve antropometrike dhe motorike, te nxënësit e moshës 17-18 vjeç të shkollave të mesme të komunës së Lipjanit, Gjimnazi "Ulpiana" dhe Shkolla Profesionale "Adem Gllavica" pa deformitete të gjoksit. Mostra për këtë hulumtimit ka përfshir gjithsej 40 nxënës të moshës 17-18 vjeçar, do të thot, 20 nxënës pa deformitete të gjoksit dhe 20 nxënës me deformitete të gjoksit të gjinisë mashkullore, ku janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – anim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet).

Tabela 1. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve antropometrike dhe motorike te nxënësit pa deformitete

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis
ALART	20	164.50	188.30	178.2350	5.47889	-.431	1.126
AGJKË	20	92.50	108.10	102.8250	5.32737	.027	-.616
APESH	20	65.20	92.40	74.3450	7.22426	1.269	1.303
APGJO	20	84.30	99.50	92.1450	5.18454	-.019	-1.219
ADBRY	20	6.10	9.00	6.8650	.45800	.861	1.514
ADGJU	20	9.10	10.30	9.7650	.34378	-.084	-1.377
AIDHK	20	4.40	20.10	9.90	4.56791	.748	.244
AIDHB	20	4.80	27.20	12.8950	6.45833	1.216	1.297
MV20L	20	3.20	3.66	3.4385	.13842	.039	-1.231
MV100L	20	12.58	13.82	13.1540	.42491	.068	-1.459
MV400L	20	66.95	95.23	80.9830	7.75787	-.013	-1.103
MV800L	20	177.37	199.54	187.4030	5.90533	.404	-.198
MKVGJ	20	172.00	213.00	194.4000	13.88069	1.011	1.611
MTDOR	20	25.00	41.00	31.7000	4.50847	.578	-.502
MFPPA	20	24.00	42.00	32.2000	5.24756	.236	-1.002

Mesatarja aritmetikore e ndryshores antropometrike, Lartësia e trupit (ALART) është 178.23 cm. Rezultati minimal (164.50 cm) dhe ai maksimal (188.30 cm) i ndryshores Lartësia e trupit tregon për një dallim të theksuar në mes nxënësve të kësaj moshe në këtë parametër antropometrik si dhe një anim të lehtë të ndryshores ka rezultatet më të larta, sepse testi i asimetrisë është negativ (hipokurtik). Edhe pse rezultatet tregojnë se ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, shihet se lakueshmëria e fituar (Skewness) nuk tregon për një asimetri të theksuar dhe konveksiteti i distribucionit (Kurtosis) është mezokurtik

Mesatarja aritmetikore e ndryshores antropometrike, Gjatësia e këmbës (AGJKË) është 102.82 cm. Rezultati minimal (92.50 cm) dhe ai maksimal (108.10 cm) i ndryshores Gjatësia e këmbës tregon për një dallim të theksuar në mes nxënësve të kësaj moshe në këtë parametër antropometrik si dhe një anim të lehtë të ndryshores ka rezultatet më të ulëta, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Edhe pse rezultatet tregojnë se ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit maksimal dhe atij minimal, shihet se lakueshmëria e fituar (Skewness) nuk tregon për një asimetri të theksuar dhe konveksiteti i distribucionit (Kurtosis) është platokurtik

